

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**  
**DREJTIMI CIVIL**



**PROBLEMET PRAKTIKE NË REALIZIMIN E ALIMENTACIONIT**

(Punim Masteri)

Mentori:  
Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

Kandidatja:  
Liranda Jashari

Prishtinë, Tetor, 2023

## ABSTRAKTI

Alimentacioni është një aspekt i rëndësishëm i shëndetit dhe mirëqenies së njerëzve, alimentimi i referohet pagesave të urdhëruara nga gjykata që i jepen një një bashkëshorti ose ish-bashkëshorti brenda një marrëveshjeje ndarje ose divorci. Arsyeja e alimentacionit është sigurimi i mbështetjes financiare për bashkëshortin që ka të ardhura më të ulëta, ose në disa raste pa të ardhura fare.

Ky abstrakt përfshin një vlerësim të problemeve praktike që vijnë në dukje gjatë përpjekjeve për të arritur një alimentacion të shëndetshëm dhe të balancuar.

E drejta e mbajtjes (ushqimit) është një institut, i cili në mënyrë të specifikuar është rregulluar me ligjin në fuqi. Një e drejtë e tillë ekziston në mes të gjithë anëtarëve të familjes. Mbajtje mund të kërkojë vetëm personi që ka nevojë për mbajtje, dhe plotësohen kushtet specifike të caktuara me ligj, kurse mbajtjen duhet ta jap personi që sipas ligjit është i detyruar për mbajtje.

Ky punim ka për qëllim të analizojë problemet praktike në realizimin e alimentacionit. Objektivat e këtij studimi janë: analizimi i problemeve praktike në realizimin e alimentacionit, analizimi i të drejtës së mbajtjes sipas legjislacionit në Kosovë.

Si probleme që ndikojnë në mospagesën e këtij detyrimi janë:

Mes tyre janë mungesa e efikasitetit të zinxhirit gjyqësor, përfshirë zvarritjet e lëndëve të tilla në gjykata, ku këto raste nuk i konsiderojnë prioritet apo edhe mangësi në implementimin e ligjeve, e deri te problemet e ndryshme që lindin ndërmjet çifteve të shkurorëzuara për të evituar obligimet ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj kujdesit të fëmijëve;

Një tjetër arsye shumë e përhapur është edhe fenomeni i mashtrimit ekonomik gjatë procedurave, ku palët ofrojnë dëshmi të rreme para gjykatës sikur janë të papunësuar, në ndërkohë që punojnë por nuk i deklarojnë të ardhurat e tjetra, që në bashkëpunim me punëdhënësin e ofrojnë një kontratë ku figuron një pagë më të vogël, ose e tjetërsojnë pasurinë e tyre me qëllim që t'i ikin obligimit ligjor të alimentacionit.

Një problematikë tjetër që i përcjellë rastet e caktimit të alimentacionit është mungesa e përkushtimit të gjyqtarëve që ta hetojnë gjendjen faktike financiare. Në bazë të Ligjit për Familjen dhe në bazë të Kodi të Procedurës Kontestimore, gjykata obligohet që në çështje të

alimentacionit të kryejë hetime në bazë të detyrës zyrtare, pra të kërkojë dëshmitë nga institucionet financiare si banka, apo nga trusti pensional edhe agjencia kadastrale në mënyrë që të konstatohet drejt shuma e mjeteve që i padituri i ka në dispozicion dhe që duhet marrë parasysh kur të caktohet alimentacioni dhe ushqimia. Por ky hetim zakonisht nuk bëhet fare dhe shumat caktohen në mënyrë paushallë.

Metodat që janë përdorur në këtë hulumtim janë: metodat historike, metoda krahasuese, analitike dhe statistikore. Me metodën historike janë paraqitur forma historike e paraqitjes së fenomenit të alimentacionit, rëndësinë dhe funksionin e tij;

Metoda krahasuese është përdorur për t'i parë dallimet dhe ngjashmëritë që ekzistojnë për problemet praktike në realizimin e alimentacionit në vendin tonë por edhe në vendet fqinje.

Përmes metodës analitike do të analizohen kush ka të drejtë të kërkojë mbajtje, dhe përmes metodës statistikore do të pasqyroj numrin e problemeve praktike për realizimin e alimentacionit.